

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN

PËR
“KRITERET E USHTRIMIT, TË MIRATIMIT DHE TË
MONITORIMIT TË VEPRIMTARIVE KËRKIMORE-SHKENCORE NË
FONDIN PYJOR KOMBËTAR”

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i kritereve, kërkesave, mënyrën e paraqitjes dhe përgjegjësitë për kryerjen e veprimtarisë kërkimore-shkencore në Fondin Pyjor Kombëtar, të cilat duhet të kryhen në përputhje me kuadrin ligjor për pyjet dhe biodiversitetin. Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektvendimi janë mbrojtja e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë, menaxhimi i qëndrueshëm i habitateve dhe llojeve të florës dhe faunës së egër dhe të ekosistemeve pyjore duke sjellë edhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të pyjeve që mundëson një jetë më të mirë për shoqërinë sot dhe brezat e së ardhmes.

Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet” në pikën 4, të nenit 20, autorizon Këshillin e Ministrave, që me propozim të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, të përcaktojë kriteret e ushtrimit, të miratimit dhe monitorimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në Fondin Pyjor Kombëtar.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA
POLITIKE**

Projektvendimi që paraqesim për shqyrtim dhe miratim është pjesë e matricës analitike të projekt akteve për vitin 2021 (miratuar me VKM nr.1121, datë 30.12.2020, “Për miratimin e Programit të Përgjithshëm Analistik të

Relacion shpjegues për projektvendimin: “Kriteret për ushtrimin, miratimin dhe monitorimin e veprimtarive kërkimore-shkencore në Fondin Pyjor Kombëtar”

Projektakteve”). Gjithashtu projektvendimi është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave për fushën e veprimtarisë që mbulon Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Miratimi i këtij projektvendimi kontribuon gjithashtu në zbatimin e masave të parashikuara në Dokumentin e Politikave për Pyjet në Shqipëri.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi synon të miratojë kriteret e rregullat për ushtrimin dhe mënyrën e miratimit për përdorimin të burimeve pyjore, të lejes për mbledhjen e materialeve dhe të mostrave nga Fondi Pyjor Kombëtar.

Projektvendimi që paraqesim për shqyrtim do të kontribuojë në miratimin e veprimtarive kërkimore-shkencore në mënyrë të tillë që të mundësohet mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i habitateve dhe llojeve të florës dhe faunës së egër dhe të ekosistemeve pyjore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me kuadrin ligjor Kombëtar të Sektorit Pyjor dhe hartohet në zbatim të pikës 4, nen 20, të Ligjit 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon transpozimin e *acquis communautaire*.

Relacion shpjegues për projektvendimin: “Kriteret për ushtrimin, miratimin dhe monitorimin e veprimtarive kërkimore-shkencore në Fondin Pyjor Kombëtar”

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi në përmbajtje të tij ka të përcaktuar 15 pika:

Në pikat 1 dhe 2, përcaktohen kriteret që duhet të plotësojnë subjektet fizike/juridike, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë kërkimore-shkencore në Fondin Pyjor Kombëtar.

Në pikën 3, përcaktohet se kërkesa e subjekteve për miratimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në fondin pyjor bashkiak, si pjesë e fondit pyjor kombëtar, paraqitet me shkrim për miratim pranë bashkisë përkatëse, që ka në pronësi këtë fond. Kurse kërkesa për rastet e pyjeve private është përcaktuar që do miratohet nga bashkia përkatëse pasi të jëtë marrë dakordësia nga pronari (pika 13). Ndërkohë nëse kërkesa është për rastin kur bie në Zonat e Mbrojtura Mjedisore atëherë do të aplikohen kriteret e përcaktuara në VKM nr.302, datë 10.05.2019, “Për kriteret e ushtrimit, të miratimit e monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në Zonat e Mbrojtura Mjedisore. (pika 14).

Përmbajtja e dokumentacionit që i bashkëlidhet kërkesës së subjekteve fizike/juridike është sipas shtojcave nr. 1, 2 dhe 3, dhe përcaktohen në pikën 4, të këtij projektvendimi. Shtocjet “tip” janë bashkëlidhur këtij projektvendimi.

Pikat 5, 6, 7 dhe 8, trajtonë mënyrën e veprimit të strukturave përgjegjëse për pyjet, pasi kërkesa bëhet pranë bashkisë.

Në pikën 9, flitet për monitorimin dhe masat që merren nga strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki dhe Agjencia Kombëtare të Pyjeve.

Në pikën 10, shpjegohet se kërkesa për veprimtarinë kërkimore-shkencore për hulumtimin dhe studimin e bazës gjenetike të florës/faunës, duhet të bazohet në ligjin “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.

Në pikën 11, përshkruhet ku, kur dhe si do të bëhet dorëzimi i raportit përfundimtar, lidhur me veprimtarinë kërkimore-shkencore.

Në pikën 12, përshkruhet mënyra e mbajtjes dhe regjistrimit të kërkesave dhe miratimeve dhe vënia në dispozicion institucioneve përgjegjëse.

Pikat 13 dhe 14, trajtonë rastet e zhvillimit të aktivitetit kërkimore-shkencor, për rastet e pyjeve në pronësi private dhe atë të zonave të mbrojtura mjedisore.

Pika 15, ngarkon institucionet përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Relacion shpjegues për projektvendimin: “Kriteret për ushtrimin, miratimin dhe monitorimin e veprimtarive kërkimore-shkencore në Fondin Pyjor Kombëtar”

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen bashkitë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

Projektvendimi është dërguar për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Brendshme dhe Agjencisë së Vetëqeverisjes Vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga strukturat përgjegjëse për pyjet në bashkëpunim me sektorin e legjisacionit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, pasi mbikëqyrja e gjithë veprimtarisë do të kryhet nga strukturat për pyjet në bashki dhe strukturat e tjera përgjegjëse për pyjet dhe si rrjedhim kjo kosto është pjesë e shpenzimeve të pagave të punonjësve.



Relacion shpjegues për projektvendimin: "Kriteret për ushtrimin, miratimin dhe monitorimin e veprimtarive kërkimore-shkencore në Fondin Pyjor Kombëtar"